

Data_____

PROCESVERBAL
Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

Zhvillim rrjeti TM-TU në zonat problematike të qytetit Durrës dhe Shijakut (F7 dhe F9 Nst Spitalle, F45 dhe 54 Shkozet, F1, F3, F5, F7 si dhe F8 Nst Sallmone).

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45231400-9 -
Puna e ndërtimit për linjat e energjisë elektrike**

VLERA E FONDIT LIMIT:

140,970,304 (Njëqind e dyzet milion e nentëqind e shtatëdhjetë mijë e treqind e kater) Leke pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor OSSH Drejtoria Rajonale Durrës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;*
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për vitet financiare 2023, 2024, 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 35,242,576 (Tridhjetë e pesë milion e dyqind e dyzet e dy mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) Leke.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e perlogaritur e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar. (neni 43, pika 2, germa ”b” VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar). Vlera 35,242,576 (Tridhjetë e pesë milion e dyqind e dyzet e dy mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) Leke është 25 % e fondit limit të përcaktuar. Bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Vlera e përcaktuar e xhiros i shërben autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit të Prokurimit Publik, nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe parashikimet e legjislacionit të fushës, aktualisht nenin 29, të Ligjit nr. 8438, dt. 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar, ku përcaktohet: Çdo tatimpagues për gatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij Ligji.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2023, 2024, 2025, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

(Shënim: ky kriter i shërben autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, *nenit 29, të Ligjit nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Per Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohen Çdo tatimpagues pergatit deklaraten vjetore te të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij Ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.*

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vertetim nga organet e pushtetit lokal (Komuna / Bashkia) për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2025 (për NIPT-in kryesor dhe për NIPT-et sekondare), ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar (të vitit 2026) sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar në të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia ose Komuna në të cilën është regjistruar sipas QKB-se. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Për të përmbushur kërkesën e mësipërme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Referuar VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26 pika 6, dokumentacioni provues i përcaktuar mësipër duhet të paraqitet pranë Autoritetit Kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Në lidhje me kërkesën për pagesën e taksave vendore referojmë se në bazë të pikave 1 dhe 3, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në Neni 5, Rregulla të përbashkëta për taksat vendore, dhe në Kreu II, Taksat vendore, Neni 9, Llojet e taksave vendore, të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 Për Sistemin e Taksave Vendore, (i ndryshuar). Me anë të kriterit për të paraqitur dokumentacionin e shlyerjes së taksave vendore kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se ushtrojnë aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 25 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 100 % i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer)
- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar
- Aktin e kolaudimit

- b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar
- Fatura tatimore përkatëse të deklaruara në organet tatimore
- Aktin e kolaudimit

(Shënim: të përcaktohen dokumentet konkrete që kërkohen për të dëshmuar përvojën e mëparshme të ngjashme me sektorin privat, të cilat janë të nevojshme dhe i shërbejnë AK për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për

miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 25 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose 100 %, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë faktin që të krijohen kushtet për një konkurrence të hapur dhe për të mos minimizuar artificialisht numrin e operatoreve ekonomik që ofrojnë këto lloj përvojash, pavarësisht rendesise dhe kompleksitetit të objektit të procedurës të prokurimit, bazuar dhe në frymën e konkurueshmërisë që gjeneron LPP 162/2020 është gjykuar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë realizuar me kontrata të ngjashme, të jetë nën 50 % e vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose nën 200 %, e vlerës së fondit total, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues do jete realisht në gjendje të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK, e cila ka në funksionim një seri sistemesh të ndërlidhura.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- **Kategoria N.P-1** Punime germimi në toke, **Klasifikimi A**
- **Kategoria N.P-11** Ndertime për n/stacionet, **Klasifikimi C**
kabinat e transformatoreve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë)
- **Kategoria N.S-8** Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri, **Klasifikimi A**

(Shënim: përcaktoni kategoritë e nevojshme të licencës, me emërtimin e tyre në përputhje me legjislacionin e fushës, duke përcaktuar edhe nivelin minimal të klasifikimit për çdo kategori, sipas vlerave të punimeve konkrete që do kryhen, si dhe institucionin që lëshon këtë licencë).

Shënim: Në rast pjesëmarrjeje të një Operatori ekonomik të huaj, ky i fundit, Licencën e mesipërme me kategoritë e përshkruara, duhet ta ketë të njehsuar pranë organeve përkatëse në Republikën e Shqipërisë sipas legjislacionit të saj në fuqi.

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin / njehesimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë,

Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008).

Ne rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kusht duhet të plotësohet nga operatorie ekonomik i cili ka marrë përsiper punimet për të cilat kërkohet kjo licencë.

Argumentim: Licencat profesionale përputhen me natyrën, përmasat dhe vlerën e punimeve të objektit të kontratës. Keto licenca dëshmojnë aftësinë profesionale të shoqërisë për zbatimin me sukses të kontratës. Klasifikimi i kategorisë është kryer sipas vlerës së punimeve konkrete në projekt - preventiv. Kërkesa për keto licenca profesionale është percaktuar bazuar ne nenin 77, te ligjit nr.162 te dates 23.12.2020 “Per Prokurimin publik” (i ndryshuar), neni 39, pika 6/a, te VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 42, date 16.01.2008 “Per miratimin e Rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi”. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet te sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Llojet e licencave dhe klasifikimi i tyre, sipas kategorive dhe niveleve përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përlllogaritur sipas preventivit të punimeve për këtë objekt si me poshte:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
N.P - 1	Punime gërmimi në tokë	Germim gropash shtyllash	A	0 – 20 milion leke
N.P - 11	Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm	Punime izolimi, demontim percjellesi, F.V	C	51 – 100 milion leke

	dhe shpërndarjen e energjisë elektrike	kabell ABC + aksesori F.V kabell furnizimi abonentesh + aksesori		
N.S - 8	Ndërtim parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri	Montim "Box" parafabrikat (2l+1t) (kabinen parafabrikat)	A	0 – 20 milion leke

Argumentim Teknik: Qëllimi i këtij investimi është përmirësimi i sigurisë, besueshmërisë dhe cilësisë së furnizimit me energji elektrike në zonat e mbuluara nga fiderat 6kV dhe 10kV, përmes rikonstruksionit të plotë të rrjetit të tensionit të ulët (TU) dhe zëvendësimit të përçuesve ekzistues të amortizuar me kablllo ajrore të izoluara ABC me vetëmbajtje.

Ky investim konsiston në ndërtimin e kabinave të reja për zona të mbetura ishull ose ndërtimin e kabinave të reja për të mundësuar demontimin e fiderave të vjetër, në rikonstruksionin e plotë të rrjetit ekzistues të tensionit të ulët (TU) në zonat e furnizuara në kabinat që do të investohen, duke përdorur kablllo ajrore me vetëmbajtje (ABC – Aerial Bundled Cable) si të vetmen zgjidhje teknike të përshtatshme si dhe ndërtimin e unazës së qytetit të Shijakut mes fiderit 1 dhe 2.

Në këtë mënyrë, rikonstruksioni me kablllo ABC paraqitet si i vetmi variant teknikisht i justifikueshëm dhe ekonomikisht i qëndrueshëm për zonat e prekura nga investimi, duke garantuar rritjen e besueshmërisë së rrjetit, minimizimin e avarive dhe sigurimin e kapaciteteve të nevojshme për zhvillimin e mëtejshëm të konsumit.

Për kabinat e reja traseja e linjës do të jetë buzë rrugës kryesore me shtylla b/a. Shtyllat do të vendosen çdo 40-50 m dhe në këdet e saj distanca ndërmejt shtyllave do të zvogelohet. Në zbritjen e kabellit që do të furnizoj kabinat e reja dhe ekzistuese do të vendosen mbrojtëse kabelli. Në rastet e nërtimit të kabinave lidhja do të bëhet me përciellës XLPEtë njëjtë me fiderin ku do të shtohet.

Per sa mesiper, perfshihen te gjitha proceset e percaktuara ne pikat e Licensave te kerkuara.

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- a. 1 (një) Inxhinier Elektrik
- b. 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi

- Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin teknik te punimeve ne objekt, i cili duhet të jete përfshirë në liçencën e shoqërisë si drejtues teknik dhe të deklaroje se nuk eshte i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jete i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figuroje në listpagesat e shoqërisë minimumi per muajin e

fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave. Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojë vertetësinë e deklarates.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune (Drejtuesin teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi).

Sqarim: përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të **formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST**, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet te dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin).

2.3.4 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punetore minimalisht 29 (Njëzet e nente) persona, nga të cilët duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, minimumi:

a) 10 (Dhjetë) elektrikistë, të pajisur me kartela personale të sigurimit teknik minimumi me grupin II-III të vlefshme, nga të cilët minimumi 3 (tre) të jenë elektrikistë me grupin e sigurimit teknik IV të vlefshme, të leshuar nga shoqëri të akredituara në bazë të *Ligjit Nr. 8734, datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike”, i ndryshuar*

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Listpagesat e punonjesve të sipercituar të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për **muajin** e fundit të *deklaruar*, si dhe
- Kartelat përkatëse të vlefshme të sigurimit teknik për punonjesit e specializuar

b) 1 (një) punonjes që të disponojë certifikatë të trajnimit si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” i ndryshuar dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” i ndryshuar.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Certifikata e cituar më sipër, kontratë pune e vlefshme, Librezë pune

c) 2 (dy) manovratore te pajisur me karte personale te sigurimit teknik, te leshuar nga organet kompetente, te cilet duhet te jene te siguruar te pakten per muajin e fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates (nese automjetet jane ne pronesi te OE ofertues).

Ne rastin kur automjetet merren me qira, manovratoret e pajisur me karte personale te sigurimit teknik, mund te kontraktohen nga OE ofertues per realizimin e kontrates objekt procedure prokurimi.

Ne lidhje me manovratorin e makinerive te renda te paraqiten deshmite e drejtimit te leshuar nga organet perkatese.

d) 2 (dy) shofere

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Kontratë pune e vlefshme, *Deshmi Aftesie Profesionale te vlefshme (leshuar nga institucionet perkatese)*, Librezë pune .

(Në rastin kur punonjësit Manovrator/shofere janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listagesat e shoqërisë).

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Sqarim: përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet te dorëzoje dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Numri i punonjësve është kërkuar duke ju referuar përmasave dhe specifikës së Investimit që do të kryhet. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve është mbajtur në konsideratë natyra e punimeve, volumi i punimeve, zona gjeografike që mbulon ky investim i parashikuar, afati i

kryerjes së tyre duke përfshirë këtu edhe numrin total të punonjësve (Inxhinierë, teknikë, specialist, punonjës të kualifikuar, punëtorë të thjeshtë, punëtorët e mjeteve të rënda apo të thjeshta etj), e lidhur kjo me të vetmin qëllim të zbatimit të tij sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

Argumentimi Teknik:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, specifikimet teknike. Nevoja për inxhinierë në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve.

Ne lidhje me aftësitë teknike, Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Për sa me siper, është e nevojshme që Operatorët Ekonomikë të pasqyrojnë referenca të përshtatshme nga kontratat të zbatuara në të shkuarën nga ana e tyre. Inxhinieri i Ndërtimit: është përgjegjës për punimet civile që kanë të bëjnë me betonimet e shtyllave, të linjave TM/TU në objekt, siguron dhe zbatimin e kushteve të sigurisë. Inxhinieri Elektrik: është përgjegjës për zbatimin e projektit të miratuar, sipas kushteve teknike për punime në linja dhe kabina elektrike përcaktuar sipas Rregullores së Shfrytëzimit dhe Sigurimit Teknik.

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht:

Kriteri i punësimit të një inxhinieri elektrik si drejtues teknik me licencë është i rëndësishëm për disa arsye. Me qëllim ndërtimin e objektit të veprës sipas projektit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimeve teknike, sigurimit teknik dhe mbrojtjen në punë, duke qënë se vlera e preventivuar për punimet që do të kryhen është e konsiderueshme dhe parësore për objektin në përgjithësi në zbatim të Udhëzimit Nr.2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, njëësia e prokurimit vlerëson që operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, të përfshirë në licënsimin e shoqërisë, si dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Drejtuesi teknik duhet të disponojë kualifikimet e kërkuara, ku për vërtetimin e tyre, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Vendosja e një inxhinieri elektrik si drejtues teknik siguron që puna do të kryhet në përputhje me standardet teknike dhe me kujdesin e duhur për sigurinë e punonjësve dhe të mjedisit. Ky kriter ndihmon në garantimin e cilësisë së punëve. Inxhinieri elektrik si drejtues teknik është përgjegjës

për monitorimin e punimeve dhe menaxhimin e situatave teknike që mund të dalin gjatë zbatimit. Kërkesa për të siguruar që inxhinieri elektrik është i regjistruar dhe i siguruar në listat e pagesave të sigurimeve për një periudhë të caktuar siguron se operatori ekonomik respekton të gjitha detyrimet legjislative dhe siguron që punonjësit janë të mbrojtur në rast të ndonjë aksidenti ose dëmtimi. Eshte kerkuar te kete ne staf Inxhinier Ndërtimi, i cili është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e preventivit të punimeve për anën ndertimore, ndertimin e bazamentit të shtyllave të betonit, për punime civile, rikthimin në gjendjen e mëparshme të rrugës dhe përcaktimin e shtresave perberese te saj etj.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e duhur për të dëshmuar që ka përmbushur këtë kriter. Ky dokumentacion përfshin kontraten individuale të punës, diplomën e inxhinierave, CV, librezë pune dhe liste pagesa.

Autoriteti Kontraktor argumenton se kërkesa për 1 (një) ekspert që përmbush kriteret për të qenë koordinator në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizimit të punimeve është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë“, sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.“.

Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar sepunëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit.

Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret epërkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Eksperti që përmbush kriteret për të qenë koordinator në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatërealizimit të punimeve duhet të jete ne kantier per minimizimin e aksidenteve ne pune.

Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave duhet të jete ne kantier ne rastaksidentesh ne pune, për të dhënë ndihmë e parë.

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore tëkualifikimit, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës

(Shënim- argumentoni nevojën për stafin e kërkuar, duke specifikuar punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale, argumentimin mbi kërkesat

dokumentare për disponimin e këtij stafi, si dhe për llojin e licencës/certifikatës/kualifikimit të kërkuar për secilin prej tyre, nëse është rasti, duke specifikuar edhe aktin ligjor apo nënligjor konkret, ku parashikohet nevoja për licencimin apo certifikimin e tyre).

2.3.6. Operatori ekonomik ofertues që do të realizojë këto kontrate, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat perkatese të vlefshme të ISO-ve, të leshuara nga organizmat e vleresimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, që kanë lidhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

ISO 9001: **e përditësuar** për Sistemin e menaxhimit të cilësisë ose ekuivalente (të vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

ISO 14001: **e përditësuar** për Sistemin e menaxhimit të cilësisë së mjedisit ose ekuivalente (të vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

ISO 45001: **e përditësuar** për Sistemin e menaxhimit të sigurisë në punë ose ekuivalente (të vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

**** Ne rast bashkimi të operatoreve ekonomike, secili anëtar duhet të paraqesë certifikatën ISO në raport me zërat, përqindjen e marrë përsipër, sipas angazhimit me shkrim / kontratën e bashkëpunimit.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operationale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

Konkretisht:

Kërkesa Lidhur me certifikimin ISO 9001:2015 ose ekuivalent, na shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësisë.

Përkatësisht kjo lloj ISO specifikon kërkesat për një sistem cilësor të menaxhimit të cilësisë, kur një organizatë:

- Duhet të dëshmojë kapacitetin për të siguruar vazhdimisht produktin që kënaq klientin dhe

kërkesat statutore dhe normative të aplikueshme.

- Synon të përmirësojë kënaqjen e klientit, nëpërmjet aplikimit të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe garancisë të konformitetit me klientin dhe kërkesat statutore dhe normative të aplikueshme.

Kërkesa Lidhur me Certifikimin ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin.

AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis të projektit si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

Kërkesa Lidhur me Certifikimin ISO 45001 ose ekuivalente ka të bëjë me sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, ky standart është i nevojshëm pasi vete karakteristikat e punës, ku punohet në tension për demontim dhe montim pajisjesh elektrike/elektroni por dhe për stafin e nevojshëm për këtë proces OE/BO pjesmarrës duhet të vërtetojë se e menaxhon në mënyrë të sigurt sigurinë në punë.

2.3.7. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion për të përmbushur kontratën. Konkretisht, mjetet e nevojshme për të përmbushur kontratën janë:

Nr.	Pershkrimi i Automjetit	Sasia min
1	Autovinc vetshkarkues kapaciteti mbajtës 5 – 10 ton	1 copë
2	Autovinç deri në 2.5 ton	1 copë
3	Automjet transporti mbi 7 ton	1 cope
4	Vinc kulle	2 cope
5	Vibrator thellesie	1 cope
6	Betoniere 500 L	1 cope
7	Fadrom me goma	1 cope
8	Autovinc 16 ton	1 cope
9	Kenotron	1 cope
10	Aparat matje tokezimi	1 cope

11	Sharre asfalti	1 cope
12	Zlite Metalike	1 cope
13	Grejder	1 cope
14	Bitumatrice	1 cope
15	Asfaltshtruese	1 cope
16	Rul me vibrim	1 cope
18	Karroce dore	1 cope
19	Set vegla elektrikisti per TM	1 set
20	Set vegla elektrikisti per TU	1 set

Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publike, operatori ekonomik ofertues, duhet të disponojë leje e qarkullimit, çertifikata e pronësisë, çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, taksat vjetore, leja e transportit (vetëm për kamionët dhe kamionçinat), foto perkatëse ballore dhe anesore.

Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publike që merren me qira, operatori ekonomik ofertues, duhet të disponojë kontratën e qirasë e vlefshme gjatë gjithë afatit të realizimit të kontratës objekt prokurimi. Bashkangjitur kontratës së qirase duhet të jenë leja e qarkullimit, çertifikata e pronësisë, çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, taksat vjetore, leja e transportit (vetëm për kamionët dhe kamionçinat), foto perkatëse ballore dhe anesore. Për mjetet dhe pajisjet që nuk pajisen me leje qarkullimi operatori ekonomik ofertues, duhet të disponojë dokument te vlefshëm që vërteton pronësinë apo marrjen me qira të tij dhe foto perkatëse.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Për të përmbushur kërkesat e mësipërme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues i përcaktuar mesipër duhet të paraqitet pranë Autoritetit Kontraktor para lidhjes së marrëveshjes kuadër.

Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës të deklarojë vendndodhjen e mjeteve të kërkuara në procedurën e prokurimit publik si dhe te pranojë verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht: Analizat e çmimeve të zerave të preventivit janë marre në baze VKM nr. 216 datë 13.04.2023, botuar në fletoren zyrtare Nr.66, datë 19.04.2023. Analizat teknike që nuk janë në VKM Nr.216 datë 13.04.2023, janë hartuar si zera jashtë liste bazuar në librin Nr.6 "Montimi i linjave dhe nestacioneve elektrike" si edhe në librin e "Normave komunale" Çmimet e bazës materiale janë marre në baze të manualit të SAP-it-OSSH, studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga veteautoriteti Vendim nr.285 datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik".

Volumet e germimeve, betonimeve dhe të montimeve janë marre sipas standarteve të OSSH Sh.a bashkëngjitur projektit.

Për punimet e montimit që nuk janë në manual i referohemi Udhezimit nr.2 datë 08.05.2003 "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit".

Shpenzimet plotësuese janë marre 8 % sipas VKM nr. 216 datë 13.04.2023, botuar në fletoren zyrtare nr.66 datë 19.04.2023 Norma e fitimit është marre 10 % sipas VKM nr. 216 datë 13.04.2023, botuar në fletoren zyrtare nr.66 datë 19.04.2023.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike.

Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1. Në përputhje me kërkesat dhe përmasat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike dhe preventiv, për listën e artikujve si më poshtë:

- Kabllo ABC
- Kabllo Koaksial
- Kabllo TM 20 KV
- Muftë 20 KV, Koka Kablli
- Shtylla b.a.c centrifugale
- Transformator Shpërndarjeje sipas specifikimeve
- Kabina parafabrikat box sipas specifikimeve

- Ndaresa, shkarkues, siguresa TM
- Cela TM 20 KV
- Panele TU
- Aksesore per linja ABC
- Tel AL-Ç

I. Autorizim te prodhuesit / Distributorit te autorizuar per mallrat e mesiperme.

Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit / Distributorit te autorizuar si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij. Distributor duhet te provoje lidhjen me prodhuesin.

II. Ne menyre qe te krahasohet pajtueshmeria me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese: Katalogun/et ose fragmente te katalogut/eve te prodhuesit/ve per listen e mallrave objekt prokurimi, ne te cilet te tregohen dhe te specifikohen qarte materialet qe do te ofrohen. Fragmentet e Katalogut ne gjuhen shqip.

Shenim: *Fragmentet e katalogut/ve duhet te tregojne lehtesisht dhe qarte qe jane pjese katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.*

III. Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese deshmi te testimeve zyrtare te kryera, te leshuara nga institucione te autorizuar ose nga prodhuesi, qe vertetojne pajtueshmerine e materialeve te prodhuara me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara.

Shenim: Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim *Operatori ekonomik /Bashkimi i operatoreve, duhet të ofertojë vetëm me një prodhues për secilin artikull, rastet kur paraqiten autorizime nga dy ose më shumë prodhues për të njëjtin artikull, përbëjnë objekt skualifikimi.*

Kerkesat e mesiperme hartohen duke mbajtur ne konsiderate piken 8 te nenit 39 te VKM 285, ku Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, konkretisht:

Autorizimi i Prodhuesit eshte nje dokument i rendesishem, pasi pervecse tregon origjinin e mallrave qe kerkohen ne procedure, na garanton se ofertusi eshte i autorizuar per ofrim tek AK te ketyre mallrave.

Katalogu/fragmentet e katalogut te prodhuesit jep nje informacion te qarte ne lidhje me mallrat qe do te ofrohen. Ky informacion perfshin te dhena te detajuara rreth materialeve dhe karakteristikeve te mallrave.

Kerkesa per paraqitjen e testimeve zyrtare, siguron nje burim te besueshem informacioni per cilesine e mallrave te kerkuar. Testet zyrtare na ndihmojne te identifikojme paraparakishte perparosite dhe mangesite e cdo materiali te ofertes.

Argumentim: Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave.

Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Vendosja e kriterit për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit është një kriter i arsyeshëm dhe i domosdoshëm për të siguruar transparencën, cilësinë dhe besueshmërinë në procesin e blerjes së mallit të sipercituar.

Paraqitja e autorizimit të prodhuesit ose distributorit siguron që operatori ekonomik është kompetent në fushën e caktuar. Ky dokument tregon se operatori ekonomik ka marrë leje zyrtare nga prodhuesi ose distributori për të ofruar mallrat e tyre në treg. Përmes këtij kriteri, AK mund të sigurohet që operatorët ekonomikë janë të autorizuar dhe të përshtatshëm për të ofruar këto produkte. Gjithashtu kriteri për paraqitjen e autorizimit siguron një burim të qartë të informacionit në rastin e ndonjë verifikimi të nevojshëm nga ana e Autoritetit Kontraktor. Përmes informacionit të plotë të prodhuesit, si numrat e telefonit, faksit, email-it, dhe faqes së internetit, AK ka mundësi të kontaktoje me prodhuesin për të verifikuar informacionin e ofruar nga operatori ekonomik. Kjo siguron se çdo dyshim i mundshëm mbi autorizimin ose cilësinë e produkteve mund të adresohet me lehtësi dhe pa vonesë.

Kriteri për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit nënkupton që operatori ekonomik është përgatitur për të dokumentuar dhe provuar lidhjen midis tyre dhe prodhuesit të mallrave. Ky dokument siguron që operatori ekonomik është i aftë të bëjë bashkëpunim me prodhuesin dhe të sigurojë furnizimin e vazhdueshëm të mallrave. Përmes këtij kriteri, blerësit mund të sigurohen që operatori ekonomik ka arritur një marrëveshje të zyrtarizuar dhe të qëndrueshme me furnizuesin e tyre.

Kriteri i kerkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, eshte vendosur në përputhje me piken 6/b, te Nenit 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Vendosja e kriterit për paraqitjen e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit është i domosdoshëm për disa arsye të rëndësishme që ndikojnë në cilësinë e procesit të blerjes dhe realizimit të furnizimit të mallrave. Ky kriter ka për qëllim të sigurojë transparencën, cilësinë dhe kujdesin ndaj specifikimeve teknike dhe standardeve të kërkuara.

Paraqitja e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit jep një informacion të qartë në lidhje me mallrat që do të ofrohen. Ky informacion përfshin të dhëna të detajuara rreth materialeve dhe karakteristikave të mallrave. Kjo siguron që AK ka një pamje të qartë për cilësinë dhe aftësitë e mallrave që ofrohen dhe mund të bëjnë një vlerësim të mirë të ofertave.

Kriteri për paraqitjen e fragmenteve të katalogut nënkupton se operatori ekonomik është në gjendje të përmbushë specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara për mallin e planifikuar. Kjo siguron që mallrat e ofruara janë të pajtueshme me kërkesat e tenderit dhe janë të përshtatshme për detyrën specifike.

Gjithashtu kriteri për përkthimin e specifikimeve teknike në shqip është i rëndësishëm për garantimin e një komunikimi të qartë dhe të kuptueshëm me Autoritetin Kontraktor në cilësinë e bleresit. Përkthimi i specifikimeve teknike në shqip siguron Autoritetin Kontraktor të kenë një kuptim të saktë të cilësive dhe karakteristikave të mallrave. Kjo ndihmon në zvogëlimin e gabimeve dhe keqkuptimeve të mundshme gjatë furnizimit të mallrave.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike janë hartuar nga OSSH qender derguar me e mail ne Drejtorine Rajonale Durres.

– Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.

– Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.